

Lënda: Njoftim për përfituesit / institucionet financiare për garancinë bankare
Pagesat paraprake 10% e ndihmës publike (Grant)

Ju informojmë se bazuar në Marrëveshjen Sektoriale të ratifikuar, Shtojca 2 e Marrëveshjes Sektoriale, "Kuatrri i Kontrollit të Brendshëm, Seksioni 3, Aktivitetet e Kontrollit ,Dispozitat e përgjithshme plotësuese të Seksionit 3 të Shtojcës B të Marrëveshjes Kuadër, pika 3, “Procedura për parapagesat dhe garancitë”, është aprovuar për zbatimin e Programit IPARD 2014-2020, nën Thirrjen 1.

Pagesa kualifikohet si pagesë paraprake deri në 10% të ndihmës publike në lidhje me projektin, dhe do të paguhet me marrjen e garancisë bankare ose një garanci ekuivalente që korrespondon me 110% të shumës së paradhënies. Garancia ekuivalente mund të jetë “garancia e sigurimit” prej 110% të shumës së paradhënies.

Afati i vlefshmërisë së garancisë bankare është 6 muaj nga përfundimi i afatit të zbatimit të investimit sipas Kontratave individuale me përfituesit.

Garancia e paraqitur do të kontrollohet për vlefshmërinë nga Agjencia IPARD me kërkesë të thjeshtë për institucionet që lëshojnë dokumentin.

Dokumentat që praqiten pranë AZHBR janë:

- Kërkesë me shkrim për pagesën paraprake;
 - Garancia bankare ose garancia e sigurimit të kontratës;
 - Dokument identifikimi i vlefshëm;
 - Numri i Llogarisë bankare (IBAN) sipas Kontratës;
-
- Në rast se ka ndryshim të të dhënave bankare apo informacione të përfituesit duhet të bëhet Njoftim me Shkrim për Autoritetin Kontraktor, AZHBR.

<Agjencia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Rruga Muhamet Gjollesha Nr.56

1001 Tiranë, Shqipëri>